



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 171/7 prot.

Tiranë, më 18.05.2022

VENDIM
Nr. 69, datë 18.05.2022

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 33, DATË 09.03.2022

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Drejtorisë së Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit Nr. 33, datë 09.03.2022, të Komisionerit, "Mbi vlerësimin e procesit të klasifikimit të pozicionit të punës së nëpunësit *****", nga "Specialist verifikimi në terren", i cili është pjesë e shërbimit civil, në marrëdhënie pune kontraktore, në pozicionin "Inspektor verifikimi në terren", për shkak të ristrukturimit të institucionit".

KONSTATOVA SE:

Nëpërmjet informacionit të regjistruar me nr. 1058/1, datë 06.12.2021, dërguar nga nëpunësi ***** , është ngritur pretendimi se transferimi i tij për shkak ristrukturimi, nga pozicioni i punës "Specialist i verifikimit në terren" në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz, që është pjesë e shërbimit civil, në pozicionin "Inspektor i verifikimit në terren", pozicion me marrëdhënie pune kontraktore, është një veprim administrativ i kryer në kundërshtim me legjislacionin për shërbimin civil.

Pas shqyrtimit të të dhënave që përmbante informacioni i përcjellë, si dhe pas administrimit të dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Kamëz, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ mbi çështjen në fjalë.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 33, datë 09.03.2022, të Komisionerit, "Mbi vlerësimin e procesit të klasifikimit të pozicionit të punës së nëpunësit *****", nga "Specialist verifikimi në terren", i cili është pjesë e shërbimit civil, në marrëdhënie pune kontraktore, në pozicionin "Inspektor verifikimi në terren", për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Në përfundim të afatit të caktuar në Vendimin e mësipërm, Bashkia Kamëz, me shkresën nr. 2094/1 prot, datë 11.4.2022, ka informuar Komisionerin mbi procedurën e ndjekur në lidhje me procesin e ristrukturimit, duke bashkëngjitur dokumentacionin përkatës.

Konkretisht, me vendimin nr. 10704, datë 16.11.2021 është vendosur ngritja e Komitetit të Vlerësimit të institucionit të Bashkisë Kamëz, me një trup të përbërë nga Drejtori i Burimeve Njerëzore, Drejtori i Financës dhe Kontabilitetit dhe Drejtori i Çështjeve Ligjore, Liçensimit dhe Kadastrës, referuar pikës 30, të Kreut V, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 142, datë 12.3.2014, "*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*", i ndryshuar.

Me aktin nr. 10704/1 Prot, datë 19.11.2021 (*u konfirmuar nga drejtuesi i institucionit*), Komiteti i Vlerësimit në Bashkinë Kamëz, ndër të tjera ka vendosur se pozicionet e punës së punonjësve të sektorit të verifikimit në terren të taksa-tarifave vendore (14 pozicione pune) për nga natyra e detyrave që kryejnë konkretisht nuk janë ushtrim i drejtpërdrejtë i autoritetit publik dhe si të tillë nuk duhet të jenë pjesë e shërbimit civil.

Mbi këtë bazë, me aktin nr. 11013 Prot, datë 26.11.2021, ka filluar procesi i ristrukturimit, duke ngritur Komisionin e Ristrukturimit të Bashkisë Kamëz, i cili ka zbatuar strukturën e re të institucionit, miratuar me vendimin nr. 637 prot, datë 26.11.2021 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz, në përmbajtje të cilës ishte implementuar edhe vendimi i mësipërm i Komitetit të Vlerësimit, sipas të cilit regjimi juridik i marrëdhënieve të punës për sektorin e verifikimit në terren të taksa-tarifave vendore (*14 pozicione pune*), pjesë e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, ndryshonte nga marrëdhënie pune në shërbimin civil, në marrëdhënie pune me kontratë sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Vlen të theksohet fakti se akti nr. 10704/1 Prot, datë 19.11.2021, i Komitetit të Vlerësimit në Bashkinë Kamëz mbi përcaktimin e pozicioneve të punës, të cilat nuk janë pjesë e shërbimit civil, daton përpara daljes së vendimit paralajmërues të Komisionerit nr. 33/2022, objekt i këtij verifikimi, mirëpo gjatë kryerjes së hetimit administrativ ky akt nuk është vendosur në dispozicion të grupit të punës.

Në vijim, referuar akteve të praktikës së dërguar nga Bashkia Kamëz, Komisioni i Ristrukturimit ka propozuar dhe mbi këtë bazë njësia përgjegjëse ka vendosur (*shih urdhrin nr. 640, datë 01.12.2021, "Për deklarimin e lirimt nga shërbimi civil dhe vazhdimin e marrëdhënieve të punës sipas dispozitave ligjore të Kodit të Punës"*), lirimt nga shërbimi civil për shkak të ligjit, për nëpunësin ***** me detyrë "*Specialist verifikimi në terren*" pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, duke i ofruar në të njëjtën kohë atij, mundësinë e vazhdimt të marrëdhënies kontraktore të punës në të njëjtin pozicion, nëpërmjet kontratës me afat të papërcaktuar, nr. 11059/1 prot, nga data 01.12.2021 (*për të cilën nëpunësi rezulton të ketë shprehur dakordësinë referuar shkresës nr. 2094/1 prot., datë 11.4.2022, "Kthim përgjigje", drejtuar Komisionerit*).

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*" dhe

Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 33, datë 09.03.2022, të Komisionerit, “Mbi vlerësimin e procesit të klasifikimit të pozicionit të punës së nëpunësit *****”, nga “Specialist verifikimi në terren“, i cili është pjesë e shërbimit civil, në marrëdhënie pune kontraktore, në pozicionin “Inspektor verifikimi në terren“, për shkak të ristrukturimit të institucionit”.
2. Konstatimin e ligjshmërisë së procedurave të ndjekura nga ana e institucionit Bashkia Kamëz, duke zbatuar detyrimet e Vendimit Nr. 33, datë 09.03.2022.
3. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Kamëz dhe punonjësi *****.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha